**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e pranimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Majlinda Bedrolli** | **03.11.2025** | **12.11.2025** | **2025/1063** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.10.2025, OE "Arsimi Company SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/1063, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE "Ermal Syla B.I, AAB Construction SH.P.K."- Suharek, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirembajtja e rrugeve me zhavorr ne Komunen e Shtimes" me nr. të prokurimit: "617-25-8164-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur,lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

| Dispozitat e shkelura nga AK-ja |
| --- |
| **Neni 6 i ligjit te prokurimit publik – ekonomiciteti dhe efikasiteti,**<br>**Neni 7 i ligjit te prokurimit publik-barazia ne trajtim/jo –diskriminim,**<br>**Neni 59 i ligjit te prokurimit publik– Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi**<br>**Neni 60 i ligjit te prokurimit publik – Kriteret e dhenies,**<br>**Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve** |

**Pretendimi Ankimor numer 1. Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë**

Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë se:

"Operatori ekonomik duhet të posedojë Ngarkues me goma max 5 ton, minimumi 1 copë.
Si dëshmi kërkohet: Lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe e vulosur në origjinal) dhe kopjet e dokumenteve të regjistrimit për mjetet nga pika (a – e) si dhe librezat, dokumentet doganore, faturat etj. për mjetet nga pika (f – i).
Në rast se operatori ekonomik nuk i posedon pajisjet në pronësi, duhet të ofrojë marrëveshje për marrje me qira të pajisjeve, të nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët, me referencë specifike për këtë projekt dhe me validitet dhe kohëzgjatje të kontratës."

Egizston një fakt thelbësor dhe i pamohueshem që Grupi I operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë **nuk ka ofruar dokumentin e regjistrimit të mjetit për "Ngarkues me goma max 5 ton"**, ashtu siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit
Kjo **mungesë dokumentacioni** përbën **mosplotësim të kriterit teknik dhe profesional**, duke e bërë ofertën **të papërgjegjshme** dhe të **pa pranueshme** për fazën e vlerësimit.

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të tij, pretendon se "operatori i rekomanduar i plotëson të gjitha kriteret dhe ka ofertën më të lirë".
Mirëpo, **çmimi më i ulët** nuk ka asnjë vlerë ligjore nëse **operatori nuk është i përgjegjshëm**.
Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, **ofertat që nuk përmbushin kriteret kualifikuese duhet të refuzohen menjëherë**, pa kaluar në fazën e vlerësimit të çmimit.

**Zyrtari përgjegjës i prokurimit**, në vendimin e tij, i është shmangur trajtimit të pretendimit tonë thelbësor pra **nuk ka mohuar dhe as provuar që pajisja e operatorit të rekomanduar është e regjistruar**.
Po të ekzistonte një dokument i tillë, AK do ta kishte paraqitur si provë.
Mosprezantimi i dokumentit konfirmon faktin se pajisja **nuk ka regjistrim**, duke dëshmuar **mosplotësimin e drejtpërdrejtë të kriterit të detyrueshëm**.

Në këtë rast, edhe nëse komisioni i vlerësimit ka bërë një gabim, **zyrtari përgjegjës i prokurimit** është person kompetent që **miraton ose refuzon rekomandimin**, prandaj mban **përgjegjësi të plotë** për miratimin e një rekomandimi të paligjshëm.
Pra, mungesa e dokumentit të regjistrimit është fakt objektiv që **as komisioni, as ZPP nuk mund ta anashkalojnë pa cenuar ligjin.**

Në çdo procedurë prokurimi, renditja ligjore është e qartë:

Fillimisht, verifikohet **përgjegjshmëria** e operatorit ekonomik;
Vetëm operatorët që i plotësojnë kriteret kalojnë në fazën e **vlerësimit të ofertës financiare**.

Në këtë rast, operatori i rekomanduar nuk i plotëson kriteret e përgjegjshmërisë, prandaj **duhej të eliminohej automatikisht nga gara**.
Dhënia e kontratës ndaj një operatori të tillë **është në kundërshtim të hapur me ligjin dhe parimet e prokurimit publik.**

**Neni 59, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**
Autoriteti kontraktues është i detyruar të refuzojë çdo ofertë që nuk përmbush kriteret thelbësore të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 i të njëjtit Ligj – Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit**
Operatorët ekonomikë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa favorizim dhe në përputhje të rreptë me kriteret e përcaktuara paraprakisht.

**Neni 10 i Ligjit për Prokurim Publik – Parimi i transparencës dhe konkurrencës së drejtë**
AK duhet të veprojë në mënyrë transparente, duke u bazuar në dokumentet dhe provat e dorëzua

Në përputhje me ligjin, kërkojmë nga OSHP të ushtrojë kompetencat e veta, të sigurojë **zbatim të drejtë të ligjit**, **trajtim të barabartë të operatorëve**, dhe **mbrojtje të integritetit të fondeve publike**.
Vendimi i Komunës së Shtimës është **i paligjshëm**, pasi operatori i shpërblyer **nuk ka plotësuar kriterin e detyrueshëm për regjistrimin e pajisjes**, duke cenuar thelbësisht ligjshmërinë e procesit të prokurimit.

Vlen të theksohet që OE I rekomandaur në listen e makinerisë ka prezentuar se posedonë **2 copa Ngarkues me goma max 5ton, gjegjësisht :**

**Ngarkues ( lopatë), Tipi: GELH 4610,Kapaciteti 3000KG,Viti I prodhimit 1980, 1 copë dhe**

**Eskavator( ngarkues),Tipi:Kramer Allrad Radler 308/318,Kapaciteti 3900KG,viti I prodhimit 1999 1 copë.**

OE ka dorëzuar,fatura të paisjet,marrveshje,dudë doganore **MIRËPO nuk e ka dorëzuar libren e rexhistrimit dhe mospërputhje e bën ofertën e rekomanduar** të papërgjegjshme **dhe rrjedhimisht e cenon seriozisht ligjshmërinë e vlerësimit dhe rekomandimit për kontratë.**

Gjithashtu, si dëshmi plotësuese, po ua bashkëngjesim dokumentacionin përkatës që ka prezantuar ky grup i operatorëve ekonomikë, përmes të cilit qartë vërehet mungesa e dokumenteve thelbësore të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Në mënyrë të veçantë, theksojmë se në ofertën e dorëzuar në formë elektronike mungon **libreza e regjistrimit të mjetit** (**Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë** ) dokument ky i domosdoshëm për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës ligjore dhe teknike të tenderit.




| | Ngarkues (Lopate) |
|---|---|
| **Tipi:** | Gelh- 4610 |
| **Kapaciteti:** | 3,000 Kg |
| **Viti i Prodhimit:** | 1980 |

**Dokumenti Unik Doganor**

ZYRA E DESTINIMIT
2040
ZBD PRIZREN
Referenca doganore
R 1930 29/01/2018
Manifesti 2018 1208

1 DEKLARATË: IM | 4

2 Eksportuesi Nr
ZDRAVO SAVIC
VIA AL FIUME 5A
6500 BELLINZONA, ZVICËRR/CH

3 Formularët: 1 | 1
4
5 Emërtimi: 1
6 Nr. pakove: 1
7 Numri referues: 2018 #58

8 Marrësi / Importuesi Nr 810045527
N.P.T. " Dita"
BANJË
MALISHEVË

9 Personi përgjegjës financiar Nr 810045527
N.P.T. " Dita"
BANJË
MALISHEVË

10 Vend. XK nga
11 Vendi i AL cty.
12 Detajet e vlerës 84.00
13 P.P.B 1

14 Deklaruesi Nr 601710818
" Quick Services " SH.P.K.
Rr.Tringë Smajli, O 56/1, Nr.6
PRISHTINË

15 Vendi dërgues/eksportues: ZVICRRA
15 V.E. Kodi a CH b
17 V.D. Rajoni a XK b
16 Vendi origjinës: ZVICRRA
17 Vendi i destinacionit: KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në nisje/arritje: SK0193AD SK8086AG MK
19: no
20 Kushtet e dërgesës: EXW BELLINZONA, ZVICËRR/CH
21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon kufirin: SK0193AD SK8086AG MK
22 Valuta dhe shuma e përgjithshme: CHF 400.00
23 Kursi i këmbimit: 0.8561644
24 Lloji i transakc.: 1 | 1
25 Lloji transportit në kufi: 30
26 Lloji transportit Transport: 30
27 Vendi ngarkimit/shkarkimit
28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e pagesës
29 Zyra doganore hyrëse/dalëse: AL140 DURRËS
30 Lokacioni i mallrave

31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit
Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit - Numri dhe lloji
Shenja & nr i pakove: 6410
Numri dhe Lloji: 1 NG Pa paketim
Makineri te tjera ngarkuese, jo të destinuara për përdorim nëntokë

NGARKUES (LOPATE ) I PËRDORUR ME GOMA
MARKA:GELH,ULESE:1,NGJYRA:E GJELBËR,
VITI I PRODHIMIT: 1980 TIPI 4610

32 Artikull: 1 No.
33 Numri tarifor: 84295199 | 00
34 Kodi origjinës: a CH b
35 Pesha bruto (kg): 3,000.00
36 Preferenca
37 Procedura: 4000 | 000
38 Pesha Neto (kg): 3,000.00
39 Kuota
40 Dokumenti paraprak/dok. përmbledhës S/L: 5
41 Njësia plotësuese: PCE 1.00
42 Çmimi për njësi: 400.00
43 M.V.: 6 kodi

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime
Nr. Licencës D.Vle. D.Sas
84.64+0.00+0.00+0.00-0.00
D.SH. 380
Dërgesë pjesore 1/5

Kodi LSH.
45 Rregullimi: 3.710
46 Vlera Statistikore: 1,584.56

47 Llog. taksave taksat

| Lloji | Baza e taksës | Norma | Shuma | MP |
|---|---|---|---|---|
| CD | 1,584.560 | 0.000 | 0.00 | 1 |
| VT | 1,584.560 | 18.000 | 285.22 | 1 |
| | | Totali | 285.22 | 1 |

48 Llogaria e pagesës
49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISË

| | | | |
|---|---|---|---|
| Mënyra e pagesës | KESH | | |
| Numri i Pranimit | L 1957 | / | Data 29/01/2018 |
| Numri Pagesës | P 1365 | | Data 30/01/2018 |
| Garancioni | 0.00 | EUR | Data |
| Totali shërbimeve | 0.00 | EUR | |
| Totali taksave | 285.22 | EUR | |

50 Principali Nr Nënshkri

C ZYRA E NISJES

51 Zyra zyret e tranzitit vendi
Përfaqësuar nga
Vendi dhe data

52 Garancioni

Kodi
53 Zyra e destinacionit dhe vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT

Nënshkri

54 Vendi dhe data
Deklaruesi emri / përfaqësuesi
ARIAN DURGUTI AD9756

**FATURE**

**N.T.P. "DITA"**

18-SHV01-001-13

| Shitësi: | Blerësi: |
|---|---|
| N.P.T. "DITA" | AAB CONSTRUCTION SH.P.K. |
| Banjë | Adresa: LUAN HARADINAJ SOL 1 HY.1 NR.4 PRISHTINË |
| Malishevë | Qyteti: Prishtine-KOSOVA |
| Tel: 044/144-573 | Telefoni: |
| NRF: 810045527 | No fiskal: 601173800 |
| NRB: 810045527 | Num biznesi: 71102971 |
| TVSH: 330363135 | No TVSH: 330247090 |

| Data fature | Kushtet | Data e skadimit | User | Referenca | Referenti (ua) | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 24.04.2018 | | 24.04.2018 | Admin | | | 001 |

| | Kod | Emertimi | Sasia | Njesia | Cmimi pa TVSH | Rabati % | TVSH % | Cmimi me TVSH | Vlera me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 322 | Ngarkues (Lopatë) me goma i perdorur ;Marka:GELH;Ulse:1;Ngjyra: E Gjelber;viti i prodhimit:1980;Tipi | 1.00 | Copë | 516.95 | 0.00 | 18.00 | 610.00 | 610.00 |

| Normat Tatimore | Baza | TVSH | Vlera |
|---|---|---|---|
| TVSH e llogaritur 0% | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| TVSH e llogaritur 8% | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| TVSH e llogaritur 18% | 516.95 | 93.05 | 610.00 |

Vlera para zbritjes: 516.95

Rabati: 0.00

Vlera pa TVSH: 516.95

TVSH: 93.05

**Vlera per pagese: 610.00 EUR**

Pagesa: 610.00

Mbetja: 0.00

Faturoi:      Dergoi:      Pranoi:

"DITA" ... Prodhuese Tregtare ... Banjë MALISHEVË

.logaria Bankare :
NLB-1705001043009523

.ogrami i implementuar nga Pro-Data sh.p.k. www.prodata-ks.com

B Construction




| | Eskavator Ngarkues |
|---|---|
| **Tipi:** | Kramer Allrad Radler 308/318 |
| **Kapaciteti:** | 3,900 Kg |
| **Viti i Prodhimit:** | 1999 |

T: 049/356-653
E: constructionaab@gmail.com
Rruga: Luan Haradinaj Sol.1, Hyrja 1, Nr.4
Prishtina, Kosova

EUROSB
SHITJE · SERVISIM · DHËNJE ME QERA

# FATURE

23-SHV01-001-4

EURO-SB SH.P.K.
Magj. Suharekë-Prizren p.n.
810110221 330385882
049670521
euro_sb@hotmail.com

EURO-SB
• SHITJE
• SERVISIM
• DHËNJE ME QERA
Greikoc - Suharekë
+383 (0) 44 670 521
+383 (0) 49 670 521
+383 (0) 49 181 993
euro_sb@hotmail.com
Pronar: Sami & Blerim Ardyli

**Bleresi:**

**AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**

Adresa: Luan Haradinaj Sol.: 1 / Hy.: 1 / Nr.: 4

Qyteti: Prishtine-KOSOVA

Telefoni: 044-302-293

No fiskal: 601173800

Numri unik: 810842668

| Data fatura | Kushtet | Data e skadimit | User | Referenca | Referenti paj | Lokacioni |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 01.02.2023 | | 15.06.2023 | Admin | | | 001 |

| No. | Kodi | Emertimi | Sasia | Njesia | Cmimi pa TVSH | Rabati % | TVSH % | Cmimi me TVSH | Vlera me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 358 | Kramer Allrad 308-318 / Nr. serik: 308630291 / VP1999 / i perdorur Ngarkues me lug dhe pirruna i perdorur | 1.00 | Copë | 12,288.14 | 0.00 | 18.00 | 14,500.00 | 14,500.00 |

| **Normat Tatimore** | **Baza** | **TVSH** | **Vlera** |
|---|---|---|---|
| TVSH e llogaritur 0% | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| TVSH e llogaritur 8% | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| TVSH e llogaritur 18% | 12,288.14 | 2,211.86 | 14,500.00 |

Vlera para zbritjes: 12,288.14
Rabati : 0.00
Vlera pa TVSH : 12,288.14
TVSH : 2,211.86
**Vlera per pagese: 14,500.00 EUR**
Pagesa: 0.00
Mbetja: 14,500.00

Bleresi e ka shikuar mjetin e cekur ne kete Fatur dhe eshte dakort me gjendjen fizike dhe teknike te mjetit te cekur ne kete Fatur! Mjeti ne fjal eshte I perdorur dhe per kete arsye nuk ka garancion! PAS KALIMT TE AFATIT TE PAGESES APLIKOHEN NDESHKIMET SIPAS LIGJIT NE FUQI! ju faleminderit per mirkuptim dhe bashkpunim!

Faturoi: Dergoi: Pranoi:

EUROSB SUHAREKË

Llogaria Bankare : TEB Bank 2025000151587351

Programi i Implementuar nga Pro-Data sh.p.k. www.prodata-ks.com

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
EUROSB
SUHAREKË

DEKLARATË: IM 4
2080
ZBO PRISHTINA 3
Referenca doganore: R 28107 19/12/2022
Manifesti: 2022 17623
3 Formularët: 1 1
5 Emërtimi: 1
6 Nr. pakove: 1
7 Numri referues: 2022 #8

2 Marrësi / importuesi Nr 810110221
"EURO-SB" SH.P.K.
GREJ Magj. Suhareke-Prizren p.n.
SUHAREKË

8 Personi përgjegjës financiar Nr 810110221
"EURO-SB" SH.P.K.
GREJ Magj. Suhareke-Prizren p.n.
SUHAREKË

10 Vendi: DE
11 Vendi: DE
12 Detajet e vlerës: 300.00
13 P.P.B: 0

14 Deklaruesi Nr 810328931
Agjensioni Doganor " ALFA - E "
Pn, Dheu i Bardhë
Kamenicë

15 Vendi dërgues/eksportues: GJERMANIA
15 V.E.: DE
17 V.D.: XK
16 Vendi origjinës: GJERMANIA
17 Vendi i destinacionit: KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në nisje/arritje: NP053BJ AC619NP XS
19: no
20 Kushtet e dorëzimit: EXW Dettenheim,DE

21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon kufirin: NP053BJ AC619NP XS
22 Valuta dhe shuma e përgjithshme: EUR 9,000.00
23 Kursi i këmbimit: 1.0000000
24 Lloji i transakc.: 1 1

25 Lloji transportit në kufi: 30
26 Lloji transportit: 30 Transport
27 Vendi ngarkimit/shkarkimit
28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e pagesës

29 Zyra doganore hyrëse/dalëse: 3031 PKK MERDARE
30 Lokacioni i mallrave

31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit
Shenjat dhe numrat - Nr i kontejnerit - Numri dhe lloji
Shenja & nr: 308630291********
Kontejner
Numri dhe: 1 NG
Lloji: Pa paketim
Makineri te tjera ngarkuese, jo të destinuara për përdorim nëntokë

Eskavator i përdorur,ngarkues paletash 1.
Marka:KRAMER,Tipi Allrad Radler 308/318,kW :36
Orë pune 6631.98h,Viti i prodhimit:1999

32 Artikulli: 1
33 Numri tarifor: 84295190 00
34 Kodi origjinës: DE
35 Pesha bruto (kg): 3,900.00
36 Preferenca
37 Procedura: 4000 000
38 Pesha Neto (kg): 3,900.00
39 Kuota
40 Dokumenti paraprak/dok. përmbledhës: 1
41 Njësia plotësuese: PCE 1.00
42 Çmimi për njësi: 9,000.00
43 M.V.: 1

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime
300.00+0.00+0.00+0.00-0.00
D.SH. 380
Dergese Parciale

45 Rregullimi: 1.000
46 Vlera Statistikore: 9,300.00

47 Llog. e taksave fiskaal

| Lloji | Baza e taksës | Norma | Shuma | MP |
|---|---|---|---|---|
| CD | 9,300.000 | 0.000 | 0.00 | 1 |
| VT | 9,300.000 | 18.000 | 1,674.00 | 1 |
| | | Totali | 1,674.00 | 1 |

48 Llogaria e pagesës
49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISË
Mënyra e pagesës: KESH
Numri i Pranimit: L 28192 / Data 19/12/2022
Numri Pagesës: Data
Garancioni: 0.00 EUR Data
Totali shërbimeve: 0.00 EUR
Totali taksave: 1.674.00 EUR

50 Principali Nr Nënshkri
C ZYRA E NISJES
51 Zyra zyrat e tranzitit vendi
Përfaqësuar nga: Vendi dhe data:
52 Garancioni nuk vlen
Kodi
53 Zyra e destinacionit dhe vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT
Vula:
Nënshkrimi
Sealis
54 Vendi dhe data
Deklaruesi emri / përfaqësuesi
ALBI AVDILI AA9150

**Pretendimi ankimor numer 2: Greder min 14-16ton min. 1 copë**

Në Dosjen e Tenderit është specifikuar qartë se operatori ekonomik duhet të ofrojë:

"Greder min. 14–16 ton, minimumi 1 copë, dhe:
Si dëshmi kërkohet lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe vulosur në origjinal), si dhe kopjet e dokumenteve të regjistrimit për mjetet nga pika (a–e), ndërsa për mjetet nga pika (f–i) dokumentet si libreza, doganorja apo fatura.
Në rast se pajisjet nuk janë në pronësi, duhet të ofrohet marrëveshje për marrje me qira të nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët, me referencë specifike për këtë projekt dhe afat të vlefshëm për periudhën e kontratës."

Nga **dokumentacioni i ofertës së grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë**, rezulton se për pajisjen **"Greder min. 14–16 ton" nuk është ofruar asnjë dëshmi e regjistrimit të mjetit,** ndonëse kjo është kërkesë e përcaktuar në mënyrë eksplicite në Dosjen e Tenderit.
Kjo mungesë e dokumentacionit përbën **mospërmbushje të qartë dhe të pakontestueshme të kritereve të kualifikimit**.
Në rrethana të tilla, autoriteti kontraktues **nuk ka pasur asnjë bazë ligjore** për ta konsideruar ofertën e tillë të pranueshme.

Për më tepër, ne si Operator Ekonomik kemi respektuar plotësisht kërkesat e dosjes.
Për sigurimin e pajisjes **"Greder min. 14–16 ton"** me regjistrim të vlefshëm, kemi hasur vështirësi objektive në treg për shkak të numrit të kufizuar të mjeteve të këtij kapaciteti.
Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, **kemi siguruar grederin me dokumentacion të rregullt të regjistrimit dhe e kemi bashkëngjitur në ofertën tonë**, ashtu siç kërkohet.

Ndërkohë, operatori i rekomanduar për kontratë **nuk ka ofruar asnjë dëshmi të regjistrimit**, por është vlerësuar dhe rekomanduar në kundërshtim flagrant me rregullat e barazisë dhe konkurrencës së drejtë.
Ky veprim është **shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, i cili përcakton parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këtë rast, autoriteti kontraktues ka vepruar **me neglizhencë të rëndë profesionale**, duke e barazuar mungesën e një dokumenti thelbësor me përmbushje të plotë të kritereve, gjë që **deformon procesin e vlerësimit** dhe **cenon integritetin e gjithë procedurës së prokurimit**.

Prandaj, duke qenë se mungesa e librezës së regjistrimit për **"Greder min. 14–16 ton"** është fakt i provuar dhe i pakontestueshëm, kërkojmë që **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP)** të konstatojë shkeljen, të **anulojë vendimin për rekomandim të kontratës**, dhe të **urdhërojë rivlerësimin e ofertave** në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Vlen të theksohet që OE I rekomandaur në listen e makinerisë ka prezentuar se posedonë **1 copë**
**Greder min 14-16ton min. 1 copë ,gjegjësisht :**

**Nivelizues-Grader-Catapillar, Modeli 12G,viti i prodhimit 1995 numri i shasisë 3WC01986 ,** OE ka dorëzuar,fatura të paisjet,dudin doganore **MIRËPO nuk e ka dorëzuar libren e rexhistrimit dhe kjo mospërputhje e bën ofertën e rekomanduar të papërgjegjshme dhe rrjedhimisht e cenon seriozisht ligjshmërinë e vlerësimit dhe rekomandimit për kontratë.**

Gjithashtu, si dëshmi plotësuese, po ua bashkëngjesim dokumentacionin përkatës që ka prezantuar ky grup i operatorëve ekonomikë, përmes të cilit qartë vërehet mungesa e dokumenteve thelbësore të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Në mënyrë të veçantë, theksojmë se në ofertën e dorëzuar në formë elektronike mungon **libreza e regjistrimit të mjetit** (**Greder min 14-16ton min. 1 copë**) dokument ky i domosdoshëm për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës ligjore dhe teknike të tenderit.

AAB Construction

**KONTRATË MBI DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË MEKANIZMIT TE PUNUES**

E Hartuar ne Prishtine me date **22.09.2025** në mes të palëve kontraktuese:

- **AAB Construction SH.P.K me NUI:810842668** të cilën e përfaqëson z.Arlind Buzhala në cilësin e qeramarrësit.
- **Mirusha Company SH.P.K me NUI : 810317067** të cilën e përfaqëson z. Fidan Selimi-Person i Autorizuar, në cilësin e Qeradhënësit

**Lënda e kontratës:**

**DHËNJA E MEKANIZIMIT PUNUES PËR SHFRYTEZIM PËR PROJEKTIN:**
**Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes**
**Numri i prokurimit: 617-25-8164-2-2-1**
**KOMUNA SHTIME**

**Paisjet e dhëna në shfrytëzim janë:**
-1 -Greder min 14-16ton

**Neni 1.** Palët akordohen qe çmimi i qeras se mekanizmit te jete sipas marrëveshjes qe do te caktohet me kontrate te posaçme.

**Neni 2.** Kompania **Mirusha Company SH.P.K** garanton qe kompanisë **AAB Construction SHPK** të ofrojë mekanizmin me kushtet teknike të mirë në çdo moment që ajo ka nevoje për periudhën e caktuar.

**Neni 3.** **AAB Construction SHPK** pranon ofertën e ofruar nga Kompania **Mirusha Company SH.P.K.** sipas kushteve qe do te përcaktohen dhe obligohet qe kompanisë ti bëjë pagesën sipas faturës se ofruar për shërbimet e kryera

**Neni 4.** Marreveshja eshte valide nga data e nenshkrimit te kontrates deri në përfundimin e kontratës.

**AAB Construction SHPK**
**Arlind Buzhala**
**Pronar**

**Mirusha Company SH.P.K**
**Fidan Selimi**
**Person i Autorizuar**

: 049/356-653; 044/281-360
Rruga: Luan Haradinaj Sol.1, Hyrja 1, Nr.4

DOKUMENTI UNIK DOGANOR

DOGANA E KOSOVËS

2. DËRGUESI/EKSPORTUESI
A.SCHOTMAN &ZN BV
HOORNSDAM 7
3882RM PUTTEN /NL

1. DEKLARATË
IM 4

A. ZYRA DOGANORE DËRGUESE/EKSPORTUESE/DESTINUESE
MITROVICA-TERMINALI
103021000002893 05/02/2010
CS-0348

3. FORMULARË 1 1

5. ENËRTIME 01 6. NUMRI I PAKOVE 01 7. NUMRI REFERUES

8. Marrësi/Importuesi NR 70510499
,,ETNIKU" SH.P.K.
A.REXHA P.N., KLINË

9. PERSONI PËRGJEGJËS FINANCIAR 70510499
,,ETNIKU" SH.P.K.
A.REXHA P.N., KLINË

14. DEKLARUESI/PËRFAQSUESI NR T 70582171
AGJENSIONI DOGANOR ,,MONDI - SHPED"
PARKU INDUSTRIAL TREPÇA P.N. - MITROVICË

15. SHTETI DËRGUES
HOLANDA

15. Sh. Dërgues/Eksportues a) NL

16. SHTETI I ORIGJINËS
GJERMANIA

17. SHTETI I DESTINACIONIT

18. IDENTITETI NACIONAL I AUTOMJETIT TRANSPORTUES NË NISJE/ARRITJE
UE159073 / 2618UE XS

19. KON 0

20. KUSHTET E DËRGESËS
EXW PUTTEN

21. IDENTITETI NACIONAL I MJETIT AKTIV TRANSPORTUES QË KALON KUFIRIN

22. VALUTA DHE SHUMA E PËRGJITHSHME E FATURUAR
EUR 71000.00

23. KURSI I KËMBIMIT 1

24. Lloji i Transaksionit 11

25. LLOJI I KOM. NË KUFI 30

26. LLOJI I KOM. TË BRENDSHËM

27. VENDI I NGARKIMIT

28. TË DHËNAT FINANCIARE DHE BANKARE

29. ZYRA DOGANORE HYRËSE/DALËSE

30. VENDNDODHJA E MALLIT

31. PAKETIM DHE PËRSHKRIMI I MALLIT

SHENJAT DHE NUMRI - NR. I KONTEJNERIT - SASIA DHE LLOJI
01 COPE
Greder per rrafshimin e rruges(Sheshuesat dhe niveluesit)
Marka:CAT,Tipi:12 G
Viti i Prodhimit:1995
Ngjyra:E Verdhe ,Ulese:1
Nr serik:3WC01896

32. ENËRTIM 1

33. NUMRI TARIFOR I MALLIT 84292000 00

34. KODI I SHTETIT TË ORIGJINËS a) DE

35. PESHA BRUTO (KG) 15600.00

36. BENEFICIONI 100

37. PROCEDURA 40 00 1 0

38. PESHA NETO KG 15600.00

39. KUOTA

40. DEKLARATA PERMBLEDHËSE /DOKUMENTI PARAPRAK
EP 10 3021 1030210002493/1-1 1

41. NJËSIA PLOTËSUESE 1.00/ PCE

42. ÇMIMI I MALLIT 71000.00

43. MV 1

44. DOKUMENTE E SHËNIMEVE DHE INFORMATAT PLOTËSUESE
F01/20100108,T08/10NL5682052ACE6A23-
XS-6202, T06/813595,V31/2400 €,T99.

KODI LB

45. PËRSHTATJA

46. VLERA STATISTIKORE 0.00

47. LLOGARITJA STATISTIKE

| LLOJI | BAZA PER LLOGARITJE | SHKALLA E TAKSES | SHUMA | MP |
|---|---|---|---|---|
| VT | 73,400.00 | 16.00 | 11,744.00 | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | GJITHSEJ | 11,744.00 | |

48. PAGESA E MËVONSHME

49. IDENTIFIKIMI I DEPOS

B. DETAJET E LLOGARITJES

50. PERSONI PËRGJEGJËS NR
NO DEPOSIT

NENSHKRIMI

PERFAQESUAR NGA:

VENDI DHE DATA

51. ZYRA DOGANORE TRANZIT

52. GARANCIONI
0.00

C. ZYRA DOGANORE E NISJES

KODI

53. ZYRA DOGANORE DESTINUESE

D/J KONTROLLA NGA ZYRA DOGANORE E NISJES/ DESTINIMIT
REZULTATI: 05/02/2010
SASIA E PLOMBAVE:
IDENTITETI I PLOMBAVE
AFATI (DATA): 05/02/2010
NENSHKRIMI CS-0001

VULA

54. VENDI DHE DATA
05/02/2010 3:25:06 PM 101170000000437

EMRI DHE NENSHKRIMI I DEKLARUESIT PERFAQSUESIT
AGJENSIONI DOGANOR ,,MONDI - SHPED"

(Nënshkrimi i Hartuesit)


12G

**Pretendimi Ankimor numer 3: Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë**

Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë dhe pa asnjë mundësi interpretimi se:

"Operatori ekonomik duhet të posedojë Eskavator me lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët, special për hapjen e kanaleve, me kapacitet 1 $m^3$, minimumi 15 ton, minimumi 1 copë.
Si dëshmi kërkohet lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe vulosur në origjinal), si dhe kopjet e dokumenteve të regjistrimit, libreza, doganorja, faturat ose marrëveshjet e qirasë në rast se pajisjet nuk janë në pronësi."

Pra edhe këtu kemi të bëjmë me Mungesën e dëshmisë së regjistrimit të paisjes dhe specifikave teknike për "Eskavator me lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët, kapacitet 1 $m^3$, minimumi 15 ton".

Ky kriter **nuk është një kërkesë formale** është **thelbësor** dhe **detyrues**, pasi garanton që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik real për ta zbatuar kontratën me pajisje specifike dhe funksionale sipas natyrës së projektit.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të ofertës së **operatorit të rekomanduar për kontratë**, konstatohet se:

**Nuk është dorëzuar dëshmi e regjistrimit (libreza)** që vërteton se pajisja është **e regjistruar ligjërisht**,ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë,

**Nuk është dorëzuar asnjë dokument teknik** që vërteton se eskavatori i ofruar posedon **lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët**,

Dhe rrjedhimisht **nuk është dëshmuar përmbushja e kapacitetit teknik minimal** të kërkuar nga Dosja e Tenderit.

Në këto kushte, operatori i rekomanduar **ka dorëzuar ofertë të paplotë dhe të pakualifikueshme**, ndërsa **autoriteti kontraktues Komuna Shtime**, në kundërshtim të plotë me ligjin, **ka bërë vlerësim të padrejtë dhe ka rekomanduar për kontratë një ofertë që s'duhej as të kalonte fazën e verifikimit administrativ**."

Ky veprim është **shkelje flagrante** e parimeve të **barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë**, të përcaktuara me **nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik**, si dhe bie ndesh me **nenin 6 të të njëjtit ligj**, që kërkon respektim të integritetit të procesit dhe vlerësim vetëm në bazë të kritereve të dokumentuara.

Në anën tjetër, ne si Operator Ekonomik pjesëmarrës kemi qenë **plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij kriteri** dhe kemi bërë **përpjekje të jashtëzakonshme për ta siguruar eskavatorin që plotëson çdo specifikë** me **lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët, kapacitet 1 $m^3$, peshë 15 ton**, të gjitha të **dokumentuara me libreza të vlefshme regjistrimi, doganore dhe fatura përkatëse.**

Kështu, ndërsa ne kemi vepruar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, operatori i shpërblyer **nuk ka asnjë dëshmi regjistrimi, asnjë provë teknike, dhe megjithatë është rekomanduar për kontratë!**

Ky është shembull tipik i **favorizimit të paarsyeshëm dhe vlerësimit selektiv**, që **kompromenton të gjithë procesin e prokurimit publik** dhe krijon precedent të rrezikshëm për ligjshmërinë e procedurave të ardhshme.

Vlen të theksohet që OE I rekomandaur në listen e makinerisë ka prezentuar se posedonë 1 copë **Eskavtor, Tipi: Liebherr A900,kapaciteti 16,000 KG,viti I prodhimit 1997.**

OE ka dorëzuar,fatura të paisjet,dudin doganore **MIRËPO , ashtu edhe siç e specifikuam edhe më lartë, nga ana e Grupit të Operatorëve Ekonomik të rekomanduar për kontratë:**

- **Nuk është dorëzuar dëshmi e regjistrimit (libreza)** që vërteton se pajisja është **e regjistruar ligjërisht**,ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë,

- **Nuk është dorëzuar asnjë dokument teknik** që vërteton se eskavatori i ofruar posedon **lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët**,dhe

- Rrjedhimisht **nuk është dëshmuar përmbushja e kapacitetit teknik minimal** të kërkuar nga Dosja e Tenderit

Gjithashtu, si dëshmi plotësuese, po ua bashkëngjesim dokumentacionin përkatës që ka prezantuar ky grup i operatorëve ekonomikë, përmes të cilit qartë vërehet mungesa e dokumenteve thelbësore të kërkuara nga Dosja e Tenderit. Në mënyrë të veçantë, theksojmë se në ofertën e dorëzuar në formë elektronike mungon **libreza e regjistrimit të mjetit** (**Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë)** dokument ky i domosdoshëm për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës ligjore dhe teknike të tenderit.

**N.T.P. "DITA"**

**FATURE**

20-SHV01-001-39

| Shitësi: | Blerësi: |
|---|---|
| N.P.T. "DITA" | AAD CONSTRUCTION SH.P.K. |
| Banjë | Adresa: LUAN HARADINAJ SOL 1 HY.1 NR.4 PRISHTINË |
| Malishevë | Qyteti: Prishtine-KOSOVA |
| Tel: 044/144-573 | |
| NRF: 810045527 | No fiskal: 601173000 |
| NUI: 810045527 | Numri unik: 810042668 |
| TVSH: 330363135 | Nr TVSH: 330247050 |

04.08.2020 04.09.2020 Admin 001

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 496 | Eskavator I Perdorur; Marka:Liebherr;Tipi:A900;Ngjyra:E Verdhe;Viti:1997;Com-4761;KW:70;Ulse:1 Eskavator I Perdorur; Marka:Liebherr;Tipi:A900;Ngjyra:E Verdhe;Viti:1997;Com-4761;KW:70;Ulse:1 | 1.00 | Cope | 14,788.14 | 0.00 | 18.00 | 17,450.00 | 17,450.00 |

| Normat Tatimore | Baza | TVSH | Vlera |
|---|---|---|---|
| TVSH e llogaritur 0% | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| TVSH e llogaritur 8% | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| TVSH e llogaritur 18% | 14,788.14 | 2,661.86 | 17,450.00 |

Vlera para zbritjes: 14,788.14
Rabati: 0.00
Vlera pa TVSH: 14,788.14
TVSH: 2,661.86
**Vlera per pagese: 17,450.00 EUR**
Pagesa: 0.00
Mbetja: 17,450.00

Dergoi: Pranoi:

Llogaria Bankare:
NLB-1705010413008523

Programi llogaritues nga Pro-Data sh.p.k. www.prodata-ks.com

AAB Construction



| | Eskavator |
|---|---|
| **Tipi:** | Liebherr A900 |
| **Kapaciteti:** | 16,000 Kg |
| **Viti i Prodhimit:** | 1997 |

T: 049/356-653
E: constructionaab@gmail.com

Rruga: Luan Haradinaj Sol.1, Hyrja 1, Nr.4
Prishtina, Kosova


3042
BANJË
MALISHEVË
KOSOVA
PREGASSONA/CH
84295210
16.000,00
FADIL AVDYLI FAKAYS

**Në përputhje me** nenin 59, paragrafët 1 dhe 2 **të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, çdo ofertë që nuk përmbush kriteret thelbësore të Dosjes së Tenderit** duhet të refuzohet menjëherë.
**Në rastin konkret, autoriteti kontraktues ka dështuar ta zbatojë këtë dispozitë ligjore, duke e shpërblyer ofertën e një operatori që** nuk i plotëson as kriteret bazë të kualifikimit teknik**.**

Autoriteti Kontraktues, përmes vendimit të tij, pretendon se "operatori i rekomanduar i plotëson të gjitha kriteret dhe ka ofertën më të lirë".
Mirëpo, **çmimi më i ulët** nuk ka asnjë vlerë ligjore nëse **operatori nuk është i përgjegjshëm**.
Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, **ofertat që nuk përmbushin kriteret kualifikuese duhet të refuzohen menjëherë**, pa kaluar në fazën e vlerësimit të çmimit.

**Zyrtari përgjegjës i prokurimit**, në vendimin e tij, i është shmangur trajtimit të pretendimit tonë thelbësor pra **nuk ka mohuar dhe as provuar që pajisjet( të cilat I elaboruam më lartë) të operatorit të rekomanduar për kontratë janë të regjistruara.**
Po të ekzistonte një dokument i tillë, AK do ta kishte paraqitur si provë( LIBREZAT E REXHISTRIMIT)
Mosprezantimi i dokumentit konfirmon faktin se pajisjet në fjal **nuk kanë regjistrim**, duke dëshmuar **mosplotësimin e drejtpërdrejtë të kriterit të detyrueshëm**.

**Sqarim: per ekspertin/en dhe panelin shqyrtues te OSHP-së në pjesen e fundit te ankeses tone gjeni te bashkangjitur dëshmit tona dhe rexhistrimet e paisjeve që ne i posedojme dhe i kemi dorezuar me rastin e dorzimit te ofertes ngase kane qene kriter i dosjes se tenderit, ndersa operatori ekonomik i rekomanduar nuk i ka ofruar librezat e rexhistrimit per paisjet ne fjale.**

Prandaj, kërkojmë nga **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)**:

Të konstatojë shkeljet thelbësore të autoritetit kontraktues,

Të **anulojë vendimin për rekomandim të kontratës**,dhe

Të **urdhërojë rivlerësimin e ofertave** në përputhje me kërkesat ligjore dhe kriteret e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Me respekt të thellë për misionin e OSHP-së në mbrojtje të konkurrencës së ndershme dhe ligjshmërisë,kerkojme qe te merret:

**V E N D I M**

**I APROVOHET** si e bazuar Ankesa e **ARSIMI COMPANY SH.P.K.**

**II. OBLIGOHET AK-KOMUNA SHTIME që të kthej lëndën në RI-VLERSIM dha gjatë fazës së ri-vlersimit ti respektoj në përpikmëri kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen tenderit.**

## KRITERET PËR VLERËSIM

| | |
|---|---|
| **Kapaciteti teknik dhe profesional** | **Kërkesa 5. Raporti për mjetet,stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit,a. Kamion kiper me kapacitet min 15ton min. 2 cope c. Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë d. Greder min 14-16ton min. 1 copë f. Eskavator min 20ton min 2 copë g. Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë h. Eskavator me zingjir gome min 8-10ton min 1 cop® i. Eskavator me zingjir gome deri Iton min. 2 copë j. Rul per ngjeshje te dheut min 13t min 1 copë k. Cilinder min 5. min 1, Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original si deshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhelibreza, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I). Ne rast se OE nuk posedon paisjet mbi pronesine dueht te ofroje marreveshjen per marrjen me gira te paisjeve. Marreveshja duhet te jete ne emer te ketij projekti me validitet dhe kohezgjatje te kesaj kontrate e nenshkruar dhe vulosur nga te dyja palet.** |

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA SHTIME**
**OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

**NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**
*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 tëRregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**

**Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes**

| | |
|---|---|
| **Nr. i prokurimit**[1] | **617-25-8164-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **617-2025-080-221** |

| **Nr.** | **Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik** | **Vlera totale e ofertës** |
|---|---|---|
| **1.** | **Grup i Operatorëve Ekonomik Ermal Sylaj B.I.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K., Magj.suhareke-Prishtin, 23000, Duhel** | **53,660.00 €** |

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

***Komuna Shtime*** **shpërblen me kontratë : Grup i Operatorëve Ekonomik Ermal Sylaj B.I.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K., Magj.suhareke-Prishtin, 23000, Duhel : Në vlerë : 53,660.00 €**

Emri dhe mbiemri i ZPP:
Muhadin Halili

Data:13.10.2025

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me datë 10.11.2025, përmes e-mailit zyrtar i jam drejtuar AK-së për sqarime.

Me datë 10.11.2025, AK kthen përgjigje me sqarimet e kërkuara.

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Arsimi Company SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues Komuna Shtime gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratësshërbim. Vlera e parashikuar 70,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59, 60 dhe 108/A, të LPP-së. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës konkretisht kundër ofertës së OE të rekomanduar për kontratë ndërsa oferta e OE ankues është shpallur e pasuksesshme sipas letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigje si në vijim.

**Ekspertja shqyrtuese** fillimisht sqaron se me datë 10.11.2025 i është drejtuar AK-së përmes e-mailit zyrtar, duke kërkuar nga AK që të jep sqarime lidhur me regjistrimin e pajisjeve të GOE të rekomanduar për kontratë sipas kërkesës së vendosur në DT, tek "Kapaciteti teknik dhe professional", Kërkesa 5, tek dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original si deshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhe libreza, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I).". Përmes këtij e-maili kam kërkuar nga AK që të jap sqarime në lidhje me këtë dëshmi dokumentare pasi që gjatë trajtimit të shkresave të lëndës nuk kam hasur dëshmitë e regjistrimit për pajisjet e kontestuara në ofertë dhe as në platformën e-prokurimit.

Ndërsa, AK kthen përgjigje në të njëjtën ditë (10.11.2025) përmes e-mailit, si më poshtë:

Sqarim / Arsyetim

Lidhur me projektin “Mirëmbajtja e rrugëve me zhavorr në Komunën e Shtimes”, me nr. 617-25-8174-2-2-1, gjatë procesit të vlerësimit dhe rekomandimit për dhënie të kontratës, komisioni vlerësues ka bërë një lëshim teknik.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë, komisioni nuk ka konstatuar se për pikat (a–e) është e nevojshme që dokumentet të jenë të pajisura me regjistrim, ndërsa për pikat (f–i) të paraqiten me DUD dhe fatura përkatëse.

Ky lëshim ka rezultuar që nuk është kërkuar informacion shtesë nga operatori ekonomik i cili është rekomanduar për dhënie të kontratës.

Komisioni pranon këtë gabim procedural, i cili ka qenë i paqëllimshëm dhe ka ndodhur gjatë interpretimit të kërkesave të dosjes së tenderit. Sqarimi po bëhet me qëllim të transparencës dhe korrektësisë në raport me procesin e vlerësimit.

Faleminderi për bashkëpunim.

Kurse, në vijim japim përgjigjet në pretendimet ankimore të OE ankues:

**Pretendimi ankimor 1:**

OE ankues pretendon se AK e ka rekomanduar grupin e OE të cilët nuk e plotësojnë dosjen e tenderit, konkretisht listën e mjeteve apo më saktë grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dokumentin e regjistrimit të mjetit për “Ngarkues me goma max 5 ton”, ashtu siç kërkohet shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Më tej, OE ankues shton se kjo mungesë dokumentacioni përbën mosplotësim të kriterit teknik dhe profesional, duke e bërë ofertën të papërgjegjshme dhe të pa pranueshme për fazën e vlerësimit.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 1 - Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në dosje të tenderit, tek “Kapaciteti teknik dhe professional”, Kërkesa 5, pika c, AK ka kërkuar: ***“Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë”***. Si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original* ***si deshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhe libreza****, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I).*”.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesa e AK ka qenë “një ngarkues me goma, maksimumi 5 ton”, ku OE duhet të dëshmoj listën e pajisjeve me kopje të regjistrimit për mjetet nga pika **a**

deri në pikën **e**, si dhe me libreza, dud doganor dhe faturë për mjetet nga pika **f** deri në pikën **i**. Bazuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, konkretisht në dokumentin me titull "14. AAB makineria.pdf", faqe 18-19 për pajisjen ***"Ngarkues me goma max 5ton min 1 copë"*** si dëshmi dokumentare ka ofruar faturën blerëse për mjetin "ngarkues (Lopatë) me goma të markës GELH", DUD-in doganor, mirëpo nuk ka dëshmuar me dokument të regjistrimit sipas kërkesës së vendosur në dosje të tenderit. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

**Pretendimi ankimor 2:** OE ankues pretendon se grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë, për pajisjen "Greder min. 14–16 ton" nuk ka ofruar asnjë dëshmi të regjistrimit të mjetit, ndonëse kjo është kërkesë e përcaktuar në mënyrë eksplicite në Dosjen e Tenderit. Kjo mungesë e dokumentacionit përbën mos përmbushje e qartë dhe të pakontestueshme të kritereve të kualifikimit. Në rrethana të tilla, autoriteti kontraktues nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për ta konsideruar ofertën e tillë të pranueshme. OE ankues shton se ne si Operator Ekonomik kemi respektuar plotësisht kërkesat e dosjes. Për sigurimin e pajisjes "Greder min. 14–16 ton" me regjistrim të vlefshëm, kemi hasur vështirësi objektive në treg për shkak të numrit të kufizuar të mjeteve të këtij kapaciteti. Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, kemi siguruar grederin me dokumentacion të rregullt të regjistrimit dhe e kemi bashkëngjitur në ofertën tonë, ashtu siç kërkohet. Ndërkohë, operatori i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë dëshmi të regjistrimit, por është vlerësuar dhe rekomanduar në kundërshtim flagrant me rregullat e barazisë dhe konkurrencës së drejtë. Ky veprim është shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili përcakton parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 2 - Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në dosje të tenderit, tek "Kapaciteti teknik dhe professional", Kërkesa 5, pika d, AK ka kërkuar: ***"d. Greder min 14 16ton min. 1 copë"***. Kurse, si dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original si* ***deshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhe libreza****, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I).*".

Ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesa e AK ka qenë "një Greder, prej 14 ton deri 16 ton", ku OE duhet të dëshmoj listën e pajisjeve me kopje të regjistrimit për mjetet nga pika a deri në

pikën e, si dhe me libreza, dud doganor dhe faturë për mjetet nga pika f deri në pikën i. Bazuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, konkretisht në dokumentin me titull "20. Grederi Mirusha huazim.pdf", faqe 1, grupi i OE të rekomanduar për kontratë për pajisjen ***"Greder min 14 16 min"*** si dëshmi dokumentare ka ofruar "KONTRATË MBI DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË MEKANIZMIT TE PUNUES", faqe 3 të njëtit dokument është fatura tatimore e blerjes së mjetit dhe faqe 4 është DUD-i doganor, mirëpo nuk është dëshmuar me dokument të regjistrimit sipas kërkesës së vendosur në dosje të tenderit. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

**Pretendimi ankimor 3:** AK në DT ka kërkuar pajisjen "Eskavator me lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët, special për hapjen e kanaleve, me kapacitet 1 m³, minimumi 15 ton, minimumi 1 copë", kurse si dëshmi dokumentare AK ka kërkuar që lista e mjeteve të punës (e nënshkruar dhe vulosur në origjinal), si dhe kopjet e dokumenteve të regjistrimit, libreza, doganorja, faturat ose marrëveshjet e qirasë në rast se pajisjet nuk janë në pronësi.". Pra, edhe këtu kemi të bëjmë me mungesën e dëshmisë së regjistrimit të pajisjes dhe specifikave teknike për "Eskavator me lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët, kapacitet 1 m³, minimumi 15 ton". OE ankues shton se pas shqyrtimit të kujdesshëm të ofertës së operatorit të rekomanduar për kontratë, konstatohet se: Nuk është dorëzuar dëshmi e regjistrimit (libreza) që vërteton se pajisja është e regjistruar ligjërisht, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, nuk është dorëzuar asnjë dokument teknik që vërteton se eskavatori i ofruar posedon lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët, dhe rrjedhimisht nuk është dëshmuar përmbushja e kapacitetit teknik minimal të kërkuar nga Dosja e Tenderit. OE ankues pretendon se ky veprim i AK-së është në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 3 - Ekspertja shqyrtuese** sqaron se në dosje të tenderit, tek "Kapaciteti teknik dhe professional", Kërkesa 5, pika g, AK ka kërkuar: ***"g. Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë"***. Si dëshmi dokumentare është kërkuar: *"Deshmia 5.Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur original) operatori ekonime per autojmetet duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne original si* ***deshmi kopjet e dokumetit te registrimit per mjetet nga pika (a-e) dhe libreza****, dud doganor, fatur etj per mjetet nga pika (f-I).".*

Ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesa e AK ka qenë "një Eskavator me lugë rrafshuese lëvizëse në dy anët për hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 dhe minimumi 15 ton", ku OE duhet të dëshmoj listën e pajisjeve me kopje të regjistrimit për mjetet nga pika **a** deri në pikën **e**, si dhe me libreza, dud doganor dhe faturë për mjetet nga pika **f** deri në pikën **i**. Bazuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, konkretisht në dokumentin me titull "14. AAB makineria.pdf", faqe 60 për pajisjen ***"Eskavator me luge rrafshuese levizese ne dy anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 15t min 1 copë"*** si dëshmi dokumentare ka ofruar DUD-in doganor, kurse në faqe 61 të njëjtit dokument gjendet fatura blerëse në emër të mjetit Liebherr A900, mirëpo nuk ka dëshmuar me dokument të regjistrimit sipas kërkesës së vendosur në dosje të tenderit. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

**Pretendimi ankimor 4:** OE ankues pretendon se AK me rastin e kërkesës për ri shqyrtim, AK nuk i ka kthyer përgjigje në pretendimet ankimore duke vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Ekspertja shqyrtuese** bazuar në shkresat e lëndës, konkretisht në kërkesën për rishqyrtim të datës 17.10.2025 nga OE ankues, sqaron se i njëjti ka kundërshtuar vendimin e AK-së me arsyet e dhëna si në këtë ankesë kundër ofertës së grupit të OE të rekomanduar për kontratë, kurse AK me datë 20.10.2025, nxjerrë vendimin me nr. Prot. 03/1/155, duke refuzuar kërkesën për rishqyrtim por në asnjë pikë nuk jep përgjigje sipas kërkesë së OE-së. Mos ofrimi i përgjigjes sipas kërkesës për ri shqyrtim bie ndesh me paragrafin 8, pika 8.4 të nenit 108/A të LPP-së, sepse kjo dispozitë përcakton që AK do ta refuzoj një kërkese për ri shqyrtim kur: "Autoriteti Kontraktues e ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptim të asaj qe kërkohet nga ankuesi". Përderisa paragrafi 9, i nenit 108/A, të LPP-së, përcakton që: "Refuzimi do të **arsyetohet** dhe do ti komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj parashtruesit të ankesës dhe te gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë...". Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

**Pretendimi ankimor 5:** OE ankues në ankesë potencon se në përputhje me nenin 59, par. 1 dhe 2 të LPP-së, çdo ofertë që nuk përmbush kriteret thelbësore të DT-së duhet të refuzohet menjëherë, ndërsa në rastin konkret AK ka dështuar të zbatoj këtë dispozitë ligjore duke e shpërblyer me kontratë ofertën e OE që nuk i plotëson as kriteret bazë të kualifikimit teknik.

**Përgjigje në pretendimin ankimor 5 - Ekspertja shqyrtuese** vlerëson se përderisa AK në dosje të tenderit për këto kërkesa ka kërkuar që si dëshmi dokumentare për mjetet e punës të dëshmohen me librezë të regjistrimit, ndërsa ka rekomanduar grupin e OE të cilët nuk kanë bashkangjitur librezat e regjistrimit për mjetet në fjalë, AK nuk e ka bërë vlerësimin e ofertave sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe në këtë mënyrë ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Në mbështetje të asaj që është cekur si më lartë, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK nuk e ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të vendosura në dosje të tenderit, si dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe vlerësimi i ofertave të bëhet konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së, kurse ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Arsimi Company SH.P.K.**

**Majlinda Bedrolli**